

Pyetësor mbi Studentët Shqiptarë në Universitete të Huaja

Nëntor 2005 – Qershor 2006

Autorët: Dorian Kçira, Endri Deliu, Orges Deliu, Blendi Ramaj

Përmbledhje

Mes nëntorit 2005 dhe qershorit 2006 u zhvillua një pyetësor me studentët shqiptarë që studiojnë jashtë vendlindjes. Rezultati më interesant i këtij pyetësori është tendenca që kanë studentët për kthimin në vendlindje pas mbarimit të studimeve. **Më shumë se gjysma e studentëve janë akoma të pavendosur nëse do kthehen apo jo, rreth një e katërta mendojnë të kthehen, rreth 15% mendojnë të jetojnë mes vendlindjes dhe një vendi tjetër dhe vetëm rreth 10% mendojnë se nuk do kthehen.** Rezultatet e këtij pyetësori mund të ndihmojnë në krijimin e një strategjie për të ashtuquajturin „kthimi i trurit“ - brain gain.

Mbështetur nga:

[Rrjeti Internacional i Shoqatave
Studentore Shqiptare](#)



Kontakti:

pyetesor@albstudent.net
www.albstatistic.com

Pasqyra e Lëndës

1. Hyrje.....	1
2. Mbledhja e të Dhënave.....	1
3. Gabimi Statistikor dhe Intervali i Konfidencës.....	3
4. Rezultatet për të Gjithë Studentët.....	4
5. Rezultatet për Studentët nga Shqipëria.....	4
6. Rezultatet për Studentët nga Kosova.....	5
7. Rezultatet për Studentët nga Maqedonia.....	5
8. Përfundime.....	6

Shënim

**Përdorimi i këtyre të dhënave lejohet vetëm nqs. theksohet burimi:
„Pyetësori AlbStudent 2005-2006. www.albstudent.net“**

1. Hyrje

AlbStudenti është Rrjeti Internacional i Shoqatave Studentore Shqiptare dhe përfshin disa nga shoqatat më të mëdha dhe më aktive studentore shqiptare jashtë atdheut.

Pyetësoni online i zhvilluar me mbështetjen e AlbStudentit u krye në periudhën nëntor 2005 - qershor 2006 dhe u plotësua nga 704 studentë shqiptarë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe vende të tjera të cilët studiojnë në universitete jashtë vendlindjes përkatëse.

Një qëllim i pyetësonit është nxjerrja e të dhënave bazë mbi studentët shqiptarë që studiojnë në universitete të huaja, duke përfshirë këtu në mënyrë të veçantë të dhëna mbi degët që studiojnë, moshën, gjininë e të tjerë.

Por me anë të këtij pyetësoni synohet kryesisht të hidhet dritë mbi tendencën aktuale të studentëve jashtë për t'u kthyer ose jo në vendlindjen e tyre pas studimit. Kjo tendencë merr rëndësi edhe në kuadrin e përpjekjeve aktuale të shoqërisë shqiptare për t'ju kundërvënë të ashtuquajturës „ikje e trurit“ (brain drain) nëpërmjet „kthimit të trurit“ (brain gain).

Në seksionet e mëposhtme të këtij artikulli do të përshkruhet fillimisht mbledhja e të dhënave dhe llogaritja e gabimit statistikor. Në vijim do paraqiten disa rezultate mbi gjithë kampionin dhe rezultate më të detajuara për nëngrupet sipas vendlindjes.

Shumica e tabelave dhe grafikëve të cilëve i referohet teksti gjenden në fund të këtij dokumenti.

2. Mbledhja e të Dhënave

Pyetësoni u konceptua si formular online me një numër të kufizuar të dhënash që u plotësuan nga vetë pjesëmarrësit. Kërkesa për plotësimin e këtij formulari u shpërnda në listat kryesore elektronike të studentëve që studiojnë jashtë vendlindjes dhe në lista të tjera elektronike shqiptare. Plotësimi u bë në mënyrë

plotësisht vullnetare, pa kompensim ose incentiv tjetër.

Duke pasur parasysh se

- studentët shqiptarë, ashtu si edhe kolegët e tyre të huaj, kanë pothuaj të gjithë mundësinë e lidhjes në internet, leximit të emailit dhe lundrimit në rrjet
- mbledhja e të dhënave është bërë nga ky grup në mënyrë të rastësishme

mendojmë se kampioni i mbledhur është përfaqësues për grupin që synon të studiojë ky pyetësor.

Ky pyetësor u publikua online dhe u shpërnda në listat respektive elektronike nga :

1. AlbStudent, www.albstudent.net
2. Illyria (Hamburg), www.illyria.de
3. Rinia (Vjenë), www.albrinia.com
4. New AGE (Milano), www.newgera.org
5. Voxaquila (Parmë), www.voxaquila.org
6. USAB (Bolonjë), www.albos.org/usab
7. Studenti (Zyrih), www.studenti-zh.ch
8. ASAB (Bari), www.asab.it

Gjithashtu ndihmuan në mënyrë të veçantë nëpërmjet publikimit dhe shpërndarjes së tij:

- KSSHN (Oslo), www.albaner.no/al/
- Alb-Shkenca, www.alb-shkenca.org

Plotësuesit e këtij pyetësori janë në pjesën më të madhe anëtarë të listave elektronike të shoqatave të sipërpërmendura.

Shpërndarja e plotësuesve sipas vendeve të studimeve jepet në tabelat Tabela 2.0, 2.1, 2.2 për grupet e plotësuesve nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia.

3. Gabimi Statistikor dhe Intervali i Konfidencës

Kampioni i mbledhur përbëhet nga 704 plotësues të pyetëorit. Siç është e pritshme, shumica e plotësuesve janë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Numri i plotësuesve të tjerë është i pamjaftueshëm për të nxjerrë të dhëna statistikore me vlerë dhe prandaj nuk është marrë në konsideratë në veçanti.

Sa i takon gabimit statistikor dhe fuqisë parashikuese të pyetëorit, dy janë madhësitë me rëndësi:

<u>Vendlindja</u>	<u>Plotësues</u>	<u>Gabimi Statistikor Kufi</u>
Shqipëri	475	4.49%
Kosovë	159	7.77%
Maqedoni	52	13.59%
Preshevë, Medvegjë, Bujanoc	9	-
Tjetër	9	-
Të gjithë	704	3.69%

1. gabimi statistikor dhe kufiri i tij
2. intervali i konfidencës

Gabimi u llogarit duke përdorur shpërndarjen binomiale. Kufiri i gabimit statistikor (margin of error) është një vlerësim i variacioneve në rezultatet e një matjeje që përsëritet. Sa më i vogël të jetë gabimi kufi, aq më konfidentë jemi se vlera e matur është afër asaj reale. Pra gabimi kufi statistikor tregon vlerën parashikuese të pyetëorit. Vlera në përqindje e gabimit kufi statistikor për secilin nga nën-grupet e kampionit dhe për të gjithin është dhënë në tabelën Tabela 3.0.

Intervali i konfidencës i përdorur për këtë pyetësor është ai standard 95%. Ai llogaritet nga vlera e gabimi statistikor kufi. Praktikisht, psh. për të gjithë kampionin, intervali i konfidencës 95% është $\pm 3.69\%$, për studentët nga Shqipëria $\pm 4.49\%$, e kështu me radhë.

4. Rezultatet për të Gjithë Studentët

Në këtë seksion paraqesim tre rezultate të përgjithshme mbi të gjithë plotësuesit e pyetësorit:

1. Gjinia
2. Dega e Studimeve dhe
3. Synimi pas Studimeve

Për pikën e tretë, studentët pjesëmarrës duhej të tregonin se si mendojnë se do vepronë pas përfundimit të studimeve dhe mund të zgjidhnin ndërmjet:

- Do të kthehen në vendlindje.
- Nuk do të kthehen në vendlindje.
- Do jetojnë mes vendlindjes dhe një vendi tjetër.
- Nuk e kanë vendosur akoma.

Rezultatet për të dhënat e mësipërme janë paraqitur në tabelat Tabela 4.0, 4.1, 4.2 dhe në figurat përkatëse.

5. Rezultatet për Studentët nga Shqipëria

Në këtë seksion paraqesim rezultatet e pyetësorit për studentët nga Shqipëria. Numri i plotësuesve me vendlindje Shqipërinë është 475. Përveç tre të dhënave të mësipërme të seksionit të përbashkët në këtë seksion jepen edhe të dhënat e detajuara të mëposhtme:

1. Viti i lindjes
2. Qyteti/Rrethi i gjimnazit
3. Koha që mbetet deri në përfundim të studimeve

Rezultatet për të dhënat e mësipërme janë paraqitur në tabelat Tabela 5.0, 5.1, 5.2, 5.3, 5.4, 5.5 dhe në figurat përkatëse.

6. Rezultatet për Studentët nga Kosova

Në këtë seksion paraqesim rezultatet e pyetësorit për studentët nga Kosova. Numri i plotësuesve me vendlindje Kosovën është 159. Në këtë seksion jepen të dhënat e detajuara të mëposhtme:

1. Gjinia
2. Degët e studimit
3. Viti i lindjes
4. Synimi pas studimit

Rezultatet për të dhënat e mësipërme janë paraqitur në tabelat Tabela 6.0, 6.1, 6.2, 6.3 dhe në figurat përkatëse.

7. Rezultatet për Studentët nga Maqedonia

Në këtë seksion paraqesim rezultatet e pyetësorit për studentët nga Maqedonia. Numri i plotësuesve me vendlindje Maqedoninë është 52. Në këtë seksion jepen të dhënat e detajuara të mëposhtme:

- Gjinia
- Synimi pas studimit

Rezultatet për të dhënat e mësipërme janë paraqitur në tabelat Tabela 7.0, 7.1 dhe në figurat përkatëse.

8. Përfundime

Siç shihet dhe nga rezultatet kemi një situatë të ndryshme përsa i përket ndarjes gjinore të studentëve. Ndërsa tek studentët nga Shqipëria kemi një përqindje pak më të lartë femrash, për studentët nga Kosova e Maqedonia kemi një përqindje të dukshme më të madhe meshkujsh.

Nga ana tjetër rezultatet e këtij pyetësi tregojnë qartë që ka paralele të dukshme në degët e studimit mes studentëve nga Shqipëria e atyre nga Kosova. Këtu vihet re se vetëm një pjesë e vogël e studentëve nga Shqipëria (rreth 18%) studiojnë degë me drejtim shkencor e teknik si shkenca natyrore, informatikë, inxhinieri, etj.

Studentët nga Shqipëria vijnë kryesisht nga gjimnazet e Tiranës e më pas me distancë relativisht të madhe nga Shkodra, Durrësi, Vlora, Elbasani, Fieri e Korça.

Rezultati më interesant i këtij pyetësi është tendenca që kanë studentët për kthimin në vendlindje pas mbarimit të studimeve. Më shumë se gjysma e studentëve janë akoma të pavendosur nëse do kthehen apo jo, rreth një e katërta mendojnë të kthehen, rreth 15% mendojnë të jetojnë mes vendlindjes dhe një vendit tjetër dhe vetëm rreth 10% mendojnë se nuk do kthehen.

Të pavendosurit dhe ata që nuk dëshirojnë të kthehen kanë përqindje të ngjashme mes Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë. Tek pjesa tjetër e studentëve bie në sy tendenca pak më e madhe e studentëve prej Shqipërisë për t'u kthyer si dhe tendenca pak më e madhe e studentëve prej Kosovës e Maqedonisë për të jetuar midis vendlindjes e një vendi tjetër.

Përqindja e madhe e të pavendosurve përbën, për mendimin tonë, një të dhënë të rëndësishme. Duhet pasur parasysh se kjo tendencë mund të ndryshojë me

kalimin e kohës në njërin kah a në tjetrin. Krijimi i kushteve të favorshme për riintegrimin në vendlindje të studentëve që studiojnë jashtë mund të ndryshojë balancën në favor të rikthimit të tyre dhe vendosjes së një ekuilibri dinamik mes atyre që largohen për studime jashtë dhe atyre që rikthehen në vendlindje.

Në mbyllje dëshirojmë të falenderojmë AlbStudentin për mbështetjen dhe të gjithë studentet e studentët që plotësuan pyetësin duke mundësuar realizimin e tij.

Autorët, Tetor 2006.

Tabela 4.0: Ndarja e të gjithë studentëve sipas gjinisë.

Gjinia	<u>Në vlerë absolute</u>	<u>Në përqindje</u>
Femër	323	45.88%
Mashkull	381	54.12%


Figura 4.0

Tabela 4.1: Ndarja e të gjithë studentëve sipas degëve të studimit.

Degët	Në vlerë absolute	Në përqindje
Ekonomik	176	25.00%
Shk. Sociale, Shk. Politike, Gjuhësi, Filozofi, Shk. Artistike, Dizenjo	176	25.00%
Mjekësi, Stomatologji, Farmaci, Infermieri	86	12.22%
Shk. Juridike	69	9.80%
Informatikë	68	9.66%
Inxhenieri	40	5.68%
Shk. Natyrore	28	3.98%
Arkitekturë	15	2.13%
Të tjera	46	6.53%

Figura 4.1




Tabela 4.2: Ndarja e të gjithë studentëve sipas synimit pas studimit.

Pas studimit	<u>Në vlerë absolute</u>	<u>Në përqindje</u>
Mendojnë të kthehen	164	23.30%
Nuk mendojnë të kthehen	76	10.80%
Nuk e kanë vendosur akoma	360	51.13%
Mendojnë se do të jetojnë midis vendlindjes dhe një vendi tjetër	104	14.77%

Figura 4.2




Tabela 2.0: Vendi i studimit për studentët nga Shqipëria.

Kontigjenti i Shqipërisë: vendet e studimit	Në vlerë absolute
Itali	227
USA	55
Gjermani	48
Austri	24
Turqi	24
Kanada	13
Greqi	13
Britani e Madhe	11
Francë	6
Spanjë	4
Zvicër	2
Belgjikë	2
Tjetër	46

Tabela 5.0: Ndarja e studentëve nga Shqipëria sipas gjinisë.

Gjinia	Në vlerë absolute	Në përqindje
Femër	253	53.26%
Mashkull	222	46.74%

Figura 5.0




Tabela 5.1: Ndarja e studentëve nga Shqipëria sipas vitit të lindjes.

Viti i lindjes	Në vlerë absolute	Në përqindje
para 1968	2	0.42%
1970	1	0.21%
1971	2	0.42%
1972	3	0.63%
1973	3	0.63%
1974	6	1.26%
1975	8	1.68%
1976	8	1.68%
1977	18	3.79%
1978	27	5.68%
1979	15	3.16%
1980	33	6.95%
1981	35	7.37%
1982	64	13.47%
1983	68	14.32%
1984	58	12.21%
1985	64	13.47%
1986	45	9.47%
1987	14	2.95%
1988	1	0.21%

Figura 5.1




Tabela 5.2: Ndarja e studentëve nga Shqipëria sipas qytetit/rrethit ku kanë kryer gjimnazin.

<u>Qyteti/Rrethi i gjimnazit</u>	<u>Në vlerë absolute</u>	<u>Në përqindje</u>
Tiranë	187	39.45%
Shkodër	41	8.65%
Durrës, Divjakë, Shijak, Kavajë	40	8.44%
Vlorë	21	4.43%
Elbasan	21	4.43%
Fier	17	3.59%
Korcë	13	2.74%
Të tjera	134	28.27%




Tabela 5.3: Ndarja e studentëve nga Shqipëria sipas degëve të studimit.

Degët	Në vlerë absolute	Në përqindje
Ekonomik	131	27.58%
Shk. Sociale, Shk. Politike, Gjuhësi, Filozofi, Shk. Artistike, Dizenjo	125	26.32%
Mjekësi, Stomatologji, Farmaci, Infermieri	49	10.32%
Shk. Juridike	56	11.79%
Informatikë	44	9.26%
Inxhenieri	26	5.47%
Shk. Natyrore	15	3.16%
Arkitekturë	8	1.68%
Të tjera	21	4.42%




Tabela 5.4: Ndarja e studentëve nga Shqipëria sipas kohës së mbetur deri në përfundim të studimit (në semestra)

Koha (në semestra)	Në vlerë absolute	Në përqindje
edhe 1	64	16.20%
edhe 2	66	16.71%
edhe 3	60	15.19%
edhe 4	68	17.22%
edhe 5	35	8.86%
edhe 6	32	8.10%
edhe 7	21	5.32%
edhe 8	16	4.05%
edhe 9	15	3.80%
edhe 10	4	1.01%
më shumë se 10	14	3.54%

Figura 5.4




Tabela 5.5: Ndarja e studentëve nga Shqipëria sipas synimit pas studimit.

<u>Pas studimit</u>	<u>Në vlerë absolute</u>	<u>Në përqindje</u>
Mendojnë të kthehen	122	25.68%
Nuk mendojnë të kthehen	50	10.53%
Nuk e kanë vendosur akoma	245	51.58%
Mendojnë se do të jetojnë midis vendlindjes dhe një vendi tjetër	58	12.21%


Figura 5.5

Tabela 2.1: Vendi i studimit për studentët nga Kosova.

Kontigjenti i Kosovës: vendet e studimit	Në vlerë absolute
Gjermani	68
Austri	22
USA	13
Zvicër	8
Britani e Madhe	6
Kanada	3
Itali	2
Suedi	1
Turqi	1
Greqi	1
Francë	1
Tjetër	33

Tabela 6.0: Ndarja e studentëve nga Kosova sipas gjinisë.

Gjinia	Në vlerë absolute	Në përqindje
Femër	45	28.30%
Mashkull	114	71.70%

Figura 6.0




Tabela 6.1: Ndarja e studentëve nga Kosova sipas degës.

Degët	Në vlerë absolute	Në përqindje
Ekonomik	31	19.50%
Shk. Sociale, Shk. Politike, Gjuhësi, Filozofi, Shk. Artistike, Dizenjo	36	22.64%
Mjekësi, Stomatologji, Farmaci, Infermieri	20	12.58%
Shk. Juridike	9	5.66%
Informatikë	18	11.32%
Inxhenieri	11	6.92%
Shk. Natyrore	10	6.29%
Arkitekturë	5	3.14%
Të tjera	19	11.95%

Figura 6.1




Tabela 6.2: Ndarja e studentëve nga Kosova sipas vitit të lindjes.

Viti i lindjes	Në vlerë absolute	Në përqindje
<1968	8	5.03%
1969	3	1.89%
1970	2	1.26%
1971	2	1.26%
1972	7	4.40%
1973	5	3.14%
1974	7	4.40%
1975	5	3.14%
1976	9	5.66%
1977	7	4.40%
1978	7	4.40%
1979	11	6.92%
1980	16	10.06%
1981	11	6.92%
1982	10	6.29%
1983	12	7.55%
1984	14	8.81%
1985	10	6.29%
1986	12	7.55%
1987	1	0.63%

Figura 6.2




Tabela 6.3: Ndarja e studentëve nga Kosova sipas synimit pas studimit.

Pas studimit	Në vlerë absolute	Në përqindje
Mendojnë të kthehen	35	22.01%
Nuk mendojnë të kthehen	13	8.18%
Nuk e kanë vendosur akoma	78	49.06%
Mendojnë se do të jetojnë midis vendlindjes dhe një vendi tjetër	33	20.75%


Figura 6.3

Tabela 2.2: Vendi i studimit për studentët nga Maqedonia

Vendi i studimit	Plotësues
Austri	17
Gjermani	14
USA	4
Zvicër	3
Itali	2
Francë	1
Tjetër	11

Tabela 7.0: Ndarja e studentëve nga Maqedonia sipas gjinisë.

Gjinia	Në vlerë absolute	Në përqindje
Femër	17	32.69%
Mashkull	35	67.31%

Figura 7.0




Tabela 7.1: Ndarja e studentëve nga Maqedonia sipas synimit pas studimit.

Pas studimit	<u>Në vlerë absolute</u>	<u>Në përqindje</u>
Mendojnë të kthehen	5	9.62%
Nuk mendojnë të kthehen	7	13.46%
Nuk e kanë vendosur akoma	29	55.77%
Mendojnë se do të jetojnë midis vendlindjes dhe një vendi tjetër	11	21.15%

Figura 7.1